

VENDIM
Nr. 259, datë 6.4.2016

**PËR KALIMIN E OBJEKTEVE “MONTIM-MAGAZINË-ZYRA”, “TRANXHAT”,
“REPARTI I STAMPIMIT”, “REPARTI I ELEKTROAUTO + WC”, “REPARTI MEKANIK”
DHE “FONDERIA”, TË NDËRMARRJES SË OFIÇINËS SË AUTOMJETEVE, TIRANË,
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 650, DATË 31.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË INVENTARIT (PJESA E TRETË, E KATËRT
DHE E PESTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË
TIRANË, TË QARKUT TË TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 12, 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e objekteve “Montim-magazinë-zyra”, “Tranxhat”, “Reparti i stampimit”, “Reparti i elektroauto + WC”, “Reparti mekanik” dhe “Fonderia”, të Ndërmarrjes së Ofiçinës së Automjeteve, Tiranë, ndodhur në Rrugën e Kavajës, zona kadastrale 8220, sipas listës bashkëlidhur, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

2. Objektet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 650, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e tretë, e katërt dhe e pestë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe kryere-gjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

LISTA
E OBJEKTEVE SHETETËRORE TË NDËRMARRJES SË OFIÇINËS SË
AUTOMJETEVE TIRANË, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Nr.	Objekti	Vendndodhja	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sipërfaqja
1.	“Montim-magazinë-zyra”	Tiranë	8220	---	384 m ²
2.	“Tranxhat” dhe “Reparti mekanik”	Tiranë	8220	6/14	869 m ²
3.	“Reparti i elektroauto + WC” dhe “Reparti i stampimit”,	Tiranë	8220	6/142	877 m ²
4.	“Fonderia”	Tiranë	8220	6/143	288 m ²